



A vdiq në kryq Jezusi

Description

M. Cara

Një varg i veçantë, disi i çuditshëm[1], në letrën dërguar *Hebrenjve* (5:7), ngre pyetjen e mësipërme. Më poshtë po jap dy versione përkthimesh të këtij vargu, i pari është përkthim *fjalë për fjalë*, ndërsa i dyti *i parafrazuar*, duke synuar kështu qartësinë e plotë kuptimore.

I cili, në ditët e mishit të tij, me klithma të larta dhe me lot, i ofroi lutje dhe urata atij që mund ta shpëtonte nga vdekja dhe u dëgjua për shkak të frikës së tij nga Perëndia.[2]

Në kohën e jetës së tij në tokë, Jezusi iu lut dhe i lypi me ofshame të mëdha dhe me lot Atij që ishte në gjëndje ta shpëtonte nga vdekja. Lutja e tij u plotësua.[3]

[Kuptimi i vargut: Jezusi iu lut Perëndisë së tij ta shpëtonte nga vdekja. Lutja iu dëgjua si gjithmonë[4], pra u plotësua, meqë Jezusi i frikësohej e i nënshtrohej Perëndisë.]

Mos ndoshta autori, për një moment, mendoi se Jezusi, duke qënë si Melkisedeku[5], pra pa fund jete (7:3), nuk kish si të vdiste, pasi vdekja dihet që është fundi i jetës? Apo ndoshta kish parasysh uratën prekëse të Jezusit tjetër të librit të *Siracidi*[6]?

Shpirti im i ishte afruar vdekjes...

Më kishin rrethuar gjithkah

e s'kishte kush të më ndihmojë...

Nga toka e lartësova përlutjen time

e u luta të shpëtoj nga vdekja.

E thirra Zotin: 'Ti je Ati im,

mos më lësho (braktis) ditën e ngushticës sime...

Urata ime qe vështruar (pranuar)!

Ti më shpëtove prej vdekjes...[7]

Kjo lutje duket sikur përputhet plotësisht me situatën e dëshpëruar tërë ankth të Jezusit. Duket, pse jo, tamam si një profeci për Jezusin; çifutët e kishin rrethuar, shokët e kishin braktisur me të katra, dhe ai tërë ankth i lutet Perëndisë që të mos vdiste (shih dhe Psalmet 31:5-9, 22; 64; 145:19-20). Por kjo profeci nuk konsiderohet si e tillë, nga ata të krishterë që janë mëse të bindur për të kundërtën, dmth. që Perëndia i ktheu kurrizin Jezusit derisa të vdiste i mallkuar, me qëllim që t'i lante gjynahet njerëzimit të lig.[8]

Dëshmitë e të krishterëve

Po ku e mbështesin "bindjen" e tyre të krishterët? Në ungjill, ose më mirë në 'ungjij'. Lind pyetja legjitime: A janë këto 'ungjij' të besueshëm historikisht?

Ungjilli 'lajmi i gëzuar' i Palit (Gal.3:13), i personit i cili s'ka qënë fare dëshmitar i jetës dhe vdekjes së supozuar të Jezusit, duhet përjashtuar si një dëshmi tërësisht jo-okulare; pra duhet konsideruar si opinion. Pali s'e ka njohur ndonjëherë Jezusin gjatë jetës së tij në tokë. Kjo vlen dhe për dëshminë e Jozef Smithit, themeluesit të kultit të Mormonëve apo 'profetëve' amerikanë të dëshmitarëve të Jehovahit.

Ungjijtë më të besueshëm si dëshmi historike duhet të jenë ato të apostujve që jetuan me Jezusin. Disa të krishterë pretendojnë se i posedojnë ato, ndërsa shumë të tjerë nuk janë dhe aq të bindur[9]. Le të shqyrtojmë dy prej tyre:

Ungjilli sipas Markut [14:12; 15:21, 25]. Pyetja kyç të cilës duhet t'i përgjigjet çdo kristian i njohur me historinë e Biblës është: "Kur ka vdekur Jezusi?" Marku e thotë shumë qartë (14:12) se dita e arrestimit të Jezusit ishte dita e 1-rë e Festës së të Ndormëve, pra 15 nisan (shih Lev.23:6)[10], pra pas ngrënies së darkës së Pashkës.[11] Pra, sipas Markut, Jezusi u arrestua në natën e 15 nisanit dhe pasi u gjykua nga çifutët, ai u çua herët në mëngjes tek Pilati (15:1). Pilati u dorëzon ushtarëve që ta çojnë në Golgotë për ta kryqëzuar (15:15); por kryqin nuk ia lanë Jezusit, përkundrazi detyruan një farë Simoni nga Kirena që ta mbante atë (v.21).

Jezusi u kryqëzua në 'orën e tretë' (sipas hebrenjve) ose në 09.00 të mëngjesit sipas llogaritjes sonë (më pas do të përdoret vetëm llogaritja jonë e kohës).[12] Kur erdhi mesdita u bë errësirë në tërë vendin deri afër orës 3 të mbasdrekës (v.33), pas kësaj Jezusi dha shpirt (v.37).

Ungjilli sipas Gjonit [13:1-2; 18:28; 19:14,17]. Ndërsa për Gjonin e gjithë drama e Jezusit u zhvillua përpara Pashkës:

Darka kur u tradhëtua nuk ishte darkë Pashke (13:1-2), por natën e arrestimit sapo kish hyrë data 14 nisan; dhe çifutët që e dorëzuan tek Pilati nuk deshën të hynin në ndërtesën e atij pagani që të mos ndoteshin dhe të mund të hanin Pashkën e cila ende nuk ishte flijuar (18:26).

Ishte dita kur në Tempull kishin filluar të bëheshin përgatitjet për flijimin e Pashkës, rreth orës 12.00 në mesditë (19:14), dhe Pilati e dorëzon Jezusin që të kryqëzohet (v.16). Dhe ai niset, i detyruar të mbartë vetë kryqin e vet të rëndë (v.17) deri në Golgotë (pasi Simoni nga Kirena do të kalonte aty pranë vetëm një ditë më vonë sipas Markut). Jezusi vdiq më vonë para perëndimit të diellit, pak para se të hahej darka e Pashkës (v.30-31).

Këto rrëfime ‘ungjillore’ janë të papajtueshme. Autorët flasin për data e orare të ndryshme të vdekjes. Kontradikta është reale dhe dëshmitë e tyre aspak bindëse.

Markut i ‘duket’ sikur Jezusin e kryqëzojnë në datë 15 në 09.00 të mëngjesit; Gjonit i ‘duket’ sikur e kishin kryqëzuar një ditë më parë (data 14) rreth orës 12.00 në mesditë. E megjithatë të dyja ditët janë çuditërisht “e premtë”.

Markut dhe sinoptikëve të tjerë u ‘duket’ sikur kryqin deri në Golgotë e mbajti një fshatar me emrin Simon; Gjonit iu ‘duk’ sikur kryqin e mbajti vetë Jezusi.

Teologët e krishterë e pranojnë se janë të pafuqishëm për ta ‘harmonizuar’ këtë kontradiktë serioze:

“Vështirësia kryesore është ajo që haset nga fakti se Marku, Mateu dhe Luka, në mënyrë të qartë e konsiderojnë darkën e fundit të Jezusit me të dymbëdhjetët si një darkë pashke, ndërkohë që tek Gjoni pashka dukej qartë që do të festohej vetëm të nesërmen...”

Me fjalë të tjera, Gjoni e vendos darkën e fundit dhe kryqëzimin e tij, një ditë më parë në muaj sesa sinoptistët. E megjithatë të gjithë bien dakord në vendosjen e kryqëzimit në të njëjtën ditë të javës – të premten (Mk.15:42, Mt.27:62, Lk.23:54, Gjn.19:14,31,42: përgatitja = e premtë).

Për këto fenomene të çuditshme, të cilat mund të jenë pasojë e ndonjë konfuzioni në traditën sinoptike – e cila virtualisht është një dëshmi – ose për shkak të ndonjë ndryshimi të historisë nga Gjoni, nën influencën e ndonjë motivi teologjik, asnjë shpjegim harmonizues i kënaqshëm nuk është ofruar.”

[A New Standard Bible Dictionary, 3-rd edition, fq.450]

Një gjë është e sigurt: këta dëshmitarë okularë (???) kanë përjetuar një iluzion optik, ose më qartë, ata i kanë parë gjërat ashtu siç nuk kanë ndodhur realisht. Ata kanë shkruar ashtu siç u është ‘dukur’ atyre, por meqë iu janë dukur gjëra të ndryshme, kanë shkruar natyrisht gjëra të ndryshme.

Dëshmitë e Judejve

Njëkohësisht, edhe Judejtë kanë versionin (më mirë versionet) e tyre të vdekjes së Jezusit. Në Talmud -libër traditash rabinike çifute- shkruhet se Judejtë kanë varur në vigjiljen e Pashkës (14 nisan) një profet të rremë me emrin Jeshu (Jezus), bir imoraliteti i një ushtari romak me Marien, i cili praktikonte magjinë dhe i çoi bijtë e Izraelit në idhujtari. Ndonëse ky shkrim nuk asnjë vlerë si dokument historik, por përbën thjesht një shpifje të shëmtuar, tipike çifute, ai shërben për të njohur dhe 'dukje' apo të tjera 'dëshmi okulare' të 'ekzekutimit të supozuar' të Jezusit.

Ky nuk është i vetmi version i çifutëve për vrasjen e Jezusit; sipas Sanh.52a Jezusi u dogj pasi u poshtërua në një gropë jashtëqitjesh, i zhytur deri në supe dhe iu fut me dhunë nëpërmjet gojës metal i shkrirë duke ia djegur tërë organet e brendshme. Ndërsa, sipas Sanh.56a dhe 105b ai ishte mbytur (shtrënguar në grykë) pasi ishte poshtëruar në jashtëqitje. Tani sipas tyre Jezusi është në ferr dhe si dënim, ai është duke u përvëlur në farë (spermë) të nxehtë (Gitten 57A). Pra edhe çifutët nuk mbeten mbrapa shkrimeve kristiane për kontradikta dëshmish.

Nëse refuzohet shpejgimi i iluzionit optik në lidhje me vdekjen e Jezusit, atëherë vetë janë vetë shkrimet e tyre ato që gjykojnë statusin e këtyre dëshmitarëve:

"Shumë veta, në fakt jepnin dëshmi të rreme kundër tij;

por dëshmitë e tyre nuk përkonin."[13]

Ata janë dëshmitarë të rremë që gënjejnë kundër të vërtetës për Jezusin, duke kundërshtuar sistematikisht njeri-tjetrin. Njerëz të tillë si dhe ata që i duan e përhapin gënjeshttrat e tyre nuk do të hyjnë në parajsë[14], por do të dënohen për çdo fjalë të kotë që kanë thënë[15].

Dëshmia e Kur'anit

Brenda kornizës së 'dëshmive' të sipërpërmendura, dilema çifuto-kristiane mbetet e pazgjidhshme. Kur'ani, Shpallja e fundit, i cili dëshmon të vërtetën e mbetur në shkrimet hyjnore të mëparshme, dhe njëkohësisht falsitetin e dorës njerëzore shtuar në to (Kur'an 5:48; 10:37), nuk synon t'i lërë të hutuar të krishterët dhe çifutët, në dilemat dhe kontradiktat e tyre për 'vdekjen' e Jezusit. E vërteta është se Jezusi as nuk vdiq duke u varur në ndonjë dru (pemë) nga Judejtë (Vep.5:30); ai, po ashtu, as nuk u shpua e gozhdua në ndonjë kryq apo shtyllë nga dora e huaj e të parrethprerëve romakë, gjë e cila do të përmbushte për çifutët akuzues të rremë (Gjn.10:33) në mënyrë perfekte një 'profeci' të profetit Ezekiel (28:9-10.)

Kur'ani shpejgon realitetin historik:

"Madje dhe për shkak të thënies së tyre:

'Ne e kemi vranë Mesihun

(Jezusin), Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut'.

Por ata as nuk e vranë e as nuk e gozhduan,

por atyre u përngjau (iu duk).

Ata që nuk u pajtuan rreth tij, janë në dilemë për të

dhe nuk kanë kurrfarë dije të saktë,

përveç që ushqejnë iluzione.

Dhe ata sigurisht që nuk e vranë atë,

por Allahu e ngriti atë pranë Vetes.

Allahu është i Plotfuqishëm, i Dijshëm.”

(Kur'an 4:157-158; shih 3:55 – përkthim i kuptimeve të tij)

Dhe nëse të krishterët e sotëm akoma vazhdojnë të bindur që Jezusi (sipas tyre vetë Zoti) është ofruar vullnetar të mallkohet nga Zoti, në vend të tyre e tu lajë gjynahet, ata bëjnë mirë t'i sqarojnë vetes (dhe pastaj të tjerëve) nëse ky aksion 'vullnetar' ka ndodhur vërtet ashtu siç pretendohet nga "ungjijtë" e tyre.

Por realiteti, e kundërta e iluzionit, tashmë është i qartë, për çdo person të rritur e të logjikshëm. E nëse kokëfortësia i shtyn akoma kundër së vërtetës, edhe pasi argumentat e qartë u janë prezantuar, atëherë i ftojme dhe le ti luten Perëndisë për mallkimin e atij që gënjen:

“ E vërteta është nga Zoti yt

e ti mos u bëj prej atyre që dyshojnë!

E kush të kundërshton ty në çështjen e tij (Jezusit)

pasi të është bërë e ditur e vërteta,

ti thuaj: Ejani,

i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj

gratë tona dhe gratë tuaja,

vetet tona dhe vetet tuaja,

e më pas t'i lutemi Allahut (Perëndisë të Jezusit[16])

për mallkim,

dhe mallkimi i Allahut të bjerë

mbi gënjeshtarët.”

(Kur'an 3:60-61 – përkthim i kuptimeve të tij)

REFERENCA

[1] Pavarsisht se në këtë letër, si në shumë letra të tjera të dhjatës së re, pretendohet se Jezusi vdiq i ekzekutuar si kriminel, ky varg duket sikur është futur në të gabimisht.

[2] Diodati i Ri, Përkthimi 1991-1994. (Shtypur: Legoprint S.r.l. -Trento Italy)

[3] ÓECM, 1993. (Shtypur: Jongbloed, NL-8901 BC Leeuëarden)

[4] Shiko ungjilli sipas Gjonit 11:41-42. Teksti është kategorik, dhe nuk lë të nënkuptohet ideja, se ndonjëherë mund të ketë dhe ndonjë një lënie në rrenë nga ana e Perëndisë ndaj shërbëtorit të Tij, Jezus. (A është Jezusi shërbëtori i Perëndisë? Lexoni artikullin me të njëjtin titull)

[5] Nga teksti shohim injorancën e autorit në lidhje me shkrimet e tjera kristiane; Jezusit, sipas tyre, i njihej një nënë dhe 2 gjenealogji të gjata, dhe një vdekje. Ku konsiston konkretisht ngjashmëria me Melkisedekun?

[6] Libri i Siracidit. Ky libër, i përdorur gjerësisht nga të krishterët e hershëm helenistë citohej shpesh dhe nga rabinët çifutë. Konsiderohet sot si shkrim i shenjtë kanonik nga të krishterët katolikë, ortodoksë dhe slavicë, sirianë, etj. pra nga shumica dërrmuese e të krishterëve. Protestantët dhe sekte të tjera, e konsiderojnë si të dobishëm dhe të vlefshëm për lexim, por jo në të njëjtin rang me shkrimet e tyre kanonike, prandaj s'e përfshijnë në biblat e tyre.

[7] Libri i Siracidit, 51:8-16. Shkëputur nga "Shkrimi Shenjt: Përkthim e shtjellim i Dom Simon Filipaj" (Ferizaj 1994). Ideja e tekstit mbështetet dhe nga tekste të Psalmeve, si **145:19-20; 118:4-5, 13, 17-18; 91:14-15; 34:4,**

6-7.

[8] Shiko footnote nr. 4.

[9] Autorët e Versionit LDC/ABU, fryt i bashkëpunimit ndërkonfesional katolik/evangjelist janë të mendimit se autorët e katër ungjijve nuk janë apostujt e Jezusit. Kjo shprehet qartë në hyrjet që i përkasin këtyre librave.

[10] Shiko Fjalorthin biblik tek versioni shqip i Biblës 'Diodati i ri', për festat solemne të dhjatës së vjetër fq.322.

[11] "Marku" 14:12 tregon injorancë në lidhje me ligjin e Judejve; ditën e parë të festës së të Ndormëve nuk flijohej qengji i Pashkës, por çjapi i shlyerjes së mëkateve (Num.28:22), përveç flive të tjera (17-21). Po ashtu v.17 të jep përshtypjen sikur Jezusi ulet për darkë 'kur u bë darkë', pra kur sipas judejve duhet të kish hyrë data 16 nisan.

[12] Për orën çifute mund të shohësh Fjalorthin biblik të sipërpërmendur fq.329.

[13] Marku 14:56. Marku ndoshta kurrë s'kish menduar se ky tekst një ditë do t'i referohej atij. Ironi biblike!?

[14] Zbulesa 22:15. Shpresojmë që kjo t'i frenojë ata pak misionarë të ndërgjegjshëm dhe me cipë, të paverbuar nga honoraret.

[15] Mateu 12:36-37.

[16] Lexoni artikullin Kush është Perëndia i Jezusit? për informacione plotësuese.

Date Created

16/01/2013

Author

erasmusi